

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "GJEODEZI "

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar


2.....Anëtar

1. Cili është instrumenti që mat Azimutin magnetik? **1 pikë**
A) Eklimetri
B) Busulla
C) Ekeri
D) Teodoliti
2. Cili është funksioni i libelës sferike tek instrumenti i teodolitit? **1 pikë**
A) Lexon drejtimet
B) Fokuson vizimin
C) Qendërzon instrumentin
D) Horizonton instrumentin
3. Si mënjanohet gabimi i kolimacionit ($ZZ \perp HH$) tek instrumenti i nivelës? **1 pikë**
A) E dërgojmë në repartin e instrumenteve të saktësisë së lartë
B) E rregullojmë me vidat mikrometrike
C) Kryejmë nivelim nga mesi
D) Kryejmë shumë matje
4. Në cilën nga metodat e mëposhtme fillimi i matjes së këndeve horizontale përcaktohet nga matja e kontrollit? **1 pikë**
A) Metoda me përsëritje
B) Metoda me seri
C) Metoda me kombinim
D) Tek të gjitha
5. Sa metoda mund të përdoren për matjen e këndeve horizontale në Triangolacion? **1 pikë**
A) 1 metodë
B) 2 metoda
C) 3 metoda
D) 4 metoda
6. Cila nga metodat e mëposhtme përdor formulën $D_a-b = 100 (S - P)$ në llogaritjen e distancave? **1 pikë**
A) Metoda parallaktike
B) Metoda me shirit-metër
C) Metoda optike
D) Metoda me sy-matje
7. Sa është shkalla e hartës kur emërtesa e nomeklaturës është K-34-100-C-a-2? **1 pikë**
A. 1: 25 000
B. 1: 10 000
C. 1: 50 000
D. 1: 100 000

8. Pikat e referimit të Shqipërisë (Triangolacioni shtetror) paraqet një numër pikash të fiksuara në terren të cilave u janë përcaktuar: **1 pikë**
- A) Koordinatat gjeografike
 - B) Koordinatat ortogonale
 - C) Kuotat
 - D) Të tria të dhënat e mësipërme
9. Në cilat raste duhet të bësh nivelim trigonometrik: **1 pikë**
- A) Kur kemi të bëjmë me terren të thyer malor
 - B) Kur kërkojmë saktësi matjesh
 - C) Kur duhet matur këndi vertikal
 - D) Kur vija e nivelimit është e gjatë
10. Cila nga metodat e mëposhtme përdor nivelën si instrument matës? **1 pikë**
- A) Nivelimi trigonometrik
 - B) Nivelimi barometrik
 - C) Nivelimi Hidrostatik
 - D) Nivelimi gjeometrik
11. Në cilin kuadrant rumbi është i barabartë me këndin e drejtimit? **1 pikë**
- A) Në kuadrantin e III
 - B) Në kuadrantin e II
 - C) Në kuadrantin e I
 - D) Në kuadrantin e IV
12. Shuma teorike e këndeve të brendshme në poligonin e mbyllur llogaritet me formulën? **1 pikë**
- A) $\Sigma\beta = (n-2) * 180^\circ$
 - B) $\Sigma\beta = (n-4) * 180^\circ$
 - C) $\Sigma\beta = (n+2) * 180^\circ$
 - D) $\Sigma\beta = (n-2) * 280^\circ$
13. Sa është ndryshimi i koordinatave midis pikës A dhe B kur na është dhënë $Y_A = 1500.00$ dhe $Y_B = 1000.00$? **1 pikë**
- A) $\Delta Y_{AB} = + 150.00$ m
 - B) $\Delta Y_{AB} = + 300.00$ m
 - C) $\Delta Y_{AB} = - 250.00$ m
 - D) $\Delta Y_{AB} = - 500.00$ m

14. Cila metodë është përdorur për piketimin në figurën e paraqitur?

- A) Piketimi i objektit nga objektet ekzistuese
- B) Piketimi i objektit me prerje këndore
- C) Piketimi i objektit me koordinata polare
- D) Piketimi i objektit nga rrjeti kuadratik



1 pikë

15. Cila nga formulat e mëposhtme përdoret për të llogaritur kuotën H_0 në punimet e sheshimit të sipërfaqeve të ndërtimit me metodën me profile:

1 pikë

- A) $a_0 = \frac{a_1 + a_2 + \dots + a_n}{n}$
- B) $H_0 = H_1 + \frac{V}{S}$
- C) $H_0 = \frac{1}{4n} [\sum H_I + \sum H_{II} + \sum H_{III}]$
- D) $H_0 = \frac{\sum H_i}{n}$

16. Kur bëhet piketimi i shtyllave të tensionit të lartë, në vertekse vendosen shtylla:

1 pikë

- A) Këndore
- B) Akërore
- C) Ndërmjetëse
- D) Betoni

17. Përse shërbejnë serpentinat në trasetë e rrugëve që ndërtohen në zonat malore?

1 pikë

- A) Për të shkurtuar gjatësinë e rrugës
- B) Për të rritur pjerrësinë e rrugës
- C) Për të ruajtur pjerrësinë e projektit
- D) Për të rritur gjatësinë e rrugës

18. Në cilat tipe të tuneleve përdoret metoda gjeometrike e projektimit?

1 pikë


- A) Në tunele malore
- B) Në tunele të drejtë dhe të shkurtër
- C) Në tunele shumë të gjatë
- D) Në tunele me shumë kthesa

19. Çfarë përfaqëson vija piezometrike në trasimin e tubacioneve me presion, në terren?


1 pikë

- A) Kuotën më të ulët të lëvizjes së lëngut
- B) Boshtin e trasesë
- C) Kuotën maksimale të lëvizjes së lëngut
- D) Vijën e tokës


20. Shikoni fotot e mëposhtme dhe përzgjidhni cili imazh prej tyre është imazh rasterik: **1 pikë**



1



2



3



4

- A) Imazhi 1
- B) Imazhi 2
- C) Imazhi 3
- D) Imazhi 4

21. Emërtoni cilat janë boshtet e instrumentit të teodolitit? **4 pikë**

- 1. _____
- 2. _____
- 3. _____
- 4. _____

22. Cilat janë 4 mënyrat e matjes së largësive: **4 pikë**

- 1. _____
- 2. _____
- 3. _____
- 4. _____

23. Rendisni katër të dhëna që regjistrohen tek libri i skicave ne procesin e kadastrimit: **4 pikë**

- 1. _____
- 2. _____
- 3. _____
- 4. _____

24. Të llogariten kuotat e pikave kur janë matur:

4 pikë

NR	LEXIMET m	LEXIMET P	DISNIVELI m - p	KORREKTURA $\sum m - \sum p / 4$	KUOTA (100 + h)
1	2	3	4	5	8
1	1.19				200
2	3.82	2.77			
3	3.04	2.21			
1	1.79	3.71			
		1.65			
Σ				0	

25. Cilat janë punimet fushore në rilevim takeometrik?

4 pikë

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

26. Renditni radhën e veprimeve që ndiqen për llogaritjen e detyrës së kundërt të gjeodezisë:

4 pikë

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

27. Rendit katër nga mënyrat e piketimit paraprak të objekteve në terren:

4 pikë

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

28. Cilat janë katër metodat e sheshimit të sipërfaqeve të ndërtimit :

4 pikë

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____


29. Renditni katër metoda të skanimit në gjeoinformatikë.

4 pikë

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

30. Të llogariten kuotat e pikave 1, 2, 3, dhe B, në kanalën me kuotë të kërkuar, kur janë dhënë: 4 pikë

- i. Distancat pjesore mes dy pikave, si në figurë;
- ii. Pjerrësia e kanalit $i = 2,0 \%$.
- iii. kuota e pikës fillestare $H_A = 100.0m$.



- Kuota në pikën 1: $H_1 =$ _____
- Kuota në pikën 2: $H_2 =$ _____
- Kuota në pikën 3: $H_3 =$ _____
- Kuota në pikën B: $H_B =$ _____

